

## **11 Korrik 2018**

### **Dita Botërore e Popullsisë**

Dita Botërore e Popullsisë është një fushatë ndërgjegjësimi në nivel ndërkombëtar që organizohet në mbarë botën në 11 korrik të çdo viti.

#### **Historia e Ditës Botërore të Popullsisë**

Organizimi i Ditës Botërore të Popullsisë synon të rrisë ndërgjegjësimin e njerëzve ndaj çështjeve të popullsisë në mbarë botën. Fillimisht është organizuar në vitin 1989 nga Këshilli Drejtues i Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP).

Sipas vendimeve të këtij Këshilli është rekomanduar që, çdo vit në 11 korrik duhet të organizohet Dita Botërore e Popullsisë me synim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe gjetjen e zgjidhjeve reale për të luftuar për çështjet e popullsisë.

#### **Pse organizohet Dita Botërore e Popullsisë**

Qëllimi i Këshillit Drejtues të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara është t'i kushtojë vëmendje të madhe problemeve të shëndetit riprodhues, si një nga shkaqet kryesore që dëmton shëndetin në përgjithësi dhe që çon në vdekjen e grave shtatzëna në mbarë botën.

Përmes kësaj fushate të madhe ndërgjegjësimi, njerëzit inkurajohen që të marrin pjesë në veprimtari të ndryshme për të rritur njohuritë për çështjet e popullsisë si rëndësia e planifikimit familjar për popullatën në rritje, barazia gjinore, shëndeti i nënës dhe fëmijës, varfëria, të drejtat e njeriut, të drejtat për shëndet, përdorimi i kontraceptivëve, shëndeti riprodhues, shtatzënia në adoleshencë, edukimi i vajzave, martesat e fëmijëve, infeksionet seksualisht të transmetueshme dhe të tjera.

Çështjet e lidhura me seksualitetin janë shumë të domosdoshme për t'u zgjidhur tek të rinjtë e moshës 15 deri 19 vjeç, pasi sipas statistikave vërehet se rreth 15 milionë gra të kësaj moshe lindin çdo vit, dhe rreth 4 milionë abortojnë një herë.

Disa nga objektivat për Ditën Botërore të Popullsisë mund të jenë:

- Mbrojtja dhe fuqizimi i të rinjve të të dy gjinive.
- Ofrimi i njohurive të hollësishme rreth shtyrjes së moshës së martesës dhe kontakteve seksuale, derisa të bëhen të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë e tyre.
- Edukimi i të rinjve për të shmangur shtatzënitë e padëshiruara.
- Edukimi i njerëzve për të ndryshuar mentalitetin gjinor.
- Edukimi i tyre për IST-të (Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme) për të parandaluar infeksione të ndryshme.
- Kërkesa për zbatimin e disa ligjeve dhe politikave efektive për të mbrojtur të drejtat e vajzave.
- Sigurimi me ligj i arsimimit të barabartë për vajzat dhe djemtë.
- Sigurimi i aksesit sa më të lehtë në shërbimet shëndetësore riprodhuese, si pjesë e shëndetit parësor bazë për çdo çift.

Dita Botërore e Popullsisë organizohet në nivel ndërkombëtar me një shumëllojshmëri aktiviteteve dhe ngjarjesh. Disa nga aktivitetet përfshijnë:

- Diskutimet në seminare
- Sesionet informative të arsimit
- Konkursat e shkrimit të eseve
- Konkursat publike për tema të ndryshme
- Shpërndarjen e posterave
- Aktivitetet sportive
- Poezitë, veprat e artit, sloganet
- Debatet, tryezat e rrumbullakëta
- Shpërndarjen e lajmeve përmes konferencave për shtyp dhe kanaleve televizive
- Transmetimin e programeve të lidhura me popullatën në radio dhe televizion etj.